

4 nëntor 2025,
Prishtinë

Komesari i Garave për Kategoritë e Reja i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR. I /2025-26
I KOMESARIT TË GARAVE PËR KATEGORITË E REJA

- I. KB Golden Eagle Ylli i paraqitur në Ligën U12 Lindje, largohet nga garat e mëtutjeshme** dhe në vitin e ardhshëm garues nuk mund të paraqitet në të njëjtën ligë të garave.

ARSYETIM

Gjatë shqyrtimit të situatës së krijuar me ekipin KB Golden Eagle Ylli në kuadër të Ligës U12 Lindje, Komesari i Garave për Kategoritë e Reja ka marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat e dokumentuara në raportet zyrtare të ndeshjeve dhe komunikimet përkatëse me klubin.

Ekipi i KB Golden Eagle Ylli ka njoftuar Komesarin e Garave se nuk disponon numër të mjaftueshëm lojtarësh për zhvillimin e ndeshjeve të planifikuara. Megjithatë, pavarësisht arsyetimit të dhënë nga klubi, mungesa e numrit të nevojshëm të lojtarëve dhe mosparaqitja në ndeshje përbën shkelje të dispozitave të Propozicioneve të Garave të Ligave të Kategorive të Reja.


Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën I të Vendimit Nr. I /2025-26, Komesari i Garave për Kategoritë e Reja ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Në ndeshjen e Xhiros I Liga U12 Lindje-Perëndim ndërmjet KB Golden Eagle Ylli dhe KB Kerasan, e zhvilluar me datë 25 tetor 2025 në ora 10:00, ekipi i KB Golden Eagle Ylli paraqitet vetëm me gjashtë lojtarë. Sipas nenit 4 të Propozicioneve të Garave të Ligave të Kategorive të Reja, gjegjësisht në lidhje me Ligën U12 Lindje-Perëndim, *“Në rast se skuadra vjen me më pak se 10 lojtarë/e, ndeshja nuk do të zhvillohet, ndërsa skuadra do të dënohet me (50 euro).”*
- (b) Në ndeshjen e Xhiros II Liga U12 Lindje-Perëndim ndërmjet KB Alba Basket dhe KB Golden Eagle Ylli, e paraparë të zhvillohet me datë 2 nëntor 2025 në ora 17:00, ekipi i KB Golden Eagle Ylli nuk është paraqitur për zhvillimin e ndeshjes.

- (c) Rrjedhimisht, mos-zhvillimi i ndeshjeve nga pikat (a) dhe (b) më lart ka rezultuar në regjistrimin e ndeshjeve të KB Golden Eagle Ylli me rezultat zyrtar 20:00.
- (d) Në përputhje me Propozicionet e Garave të Ligave të Kategorive të Reja, “Ekipi që në një edicion garues humb 2 ndeshje të përshkruara me nenin 28.37. dhe 28.39. do të largohet nga garat e mëtutjeshme dhe në vitin e ardhshëm garues nuk mund të paraqitet në të njëjtën ligë të garave”.
- (e) Edhe pse neni 28.39 i Propozicioneve të Garave nuk e përshkruan në mënyrë specifike rastin kur ekipi nuk paraqitet për shkak të mungesës së lojtarëve, efekti sportiv dhe disiplinor është i njëjtë, ngase në të dy rastet rezultati i ndeshjes regjistrohet zyrtarisht me 20:0 dhe ndeshja konsiderohet e humbur.
- (f) Në këtë kuptim, zbatimi i nenit 28.39 bëhet analogjikisht, duke respektuar parimin e barazisë në trajtimin e ekipeve dhe konsistencën e zbatimit të rregullave.
- (g) Prandaj, pavarësisht se arsyeja e mos-zhvillimit është mungesa e lojtarëve, kjo situatë trajtohet si humbje me rezultat zyrtar, duke bërë që ekipi të përmbushë kushtet për largim nga garat e mëtutjeshme.

Xhelal **MUMINI**

Komesar i Garave për Kategoritë e Reja



Federata e Basketbollit të Kosovës



Këshillë Juridike:

Konform Nenit 24 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë e Reja, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komesarit të Garave është e lejuar ankesa në Komisionin e Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së, e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas pranimit të vendimit (përmes postës elektronike apo dita e publikimit në ueb-faqen e FBK-së). Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 150.00 €.